



15 NËNTOR 2015

## PEZULLIMI I MARRËVESHJES PËR ASOCIACIONIN/BASHKËSINË E KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE

Më 31 tetor Presidentja Jahjaga ia procedoi Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës një kërkesë për interpretim të përputhshmërisë së marrëveshjes së 25 gushtit për Asociacionin/Bashkësinë e Komunave me Shumicë Serbe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Presidentja Jahjaga gjithashtu kërkoi që: “çdo veprim dhe efekt që prodhon Parimet e Asociacionit të pezullohet” dhe që “Gjykata Kushtetuese të vendosë masë të përkohshme ndaj çështjes së ngritur, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës”.<sup>1</sup>

*Marrëveshja hyn në gamën e çështjeve që prekin në frymën e Kushtetutës, në veçanti principet e natyrës shumë-etnike të Kosovës*

Arsyetimi për kërkesën për shqyrtim të përputhshmërisë së Marrëveshjes për Asociacionin me Kushtetutën bazohet në faktin që marrëveshja hyn në gamën e çështjeve që prekin në frymën e Kushtetutës, në veçanti nocionin e natyrës shumë-etnike të Kosovës, të drejtat themelore dhe liritë, si dhe të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.<sup>2</sup> Ekzistojnë shqetësime të arsyeshme për natyrën mono-etnike të

Asociacionit, që thotë se Asociacioni ekziston që të “të promovojë intereset e komunitetit serb të Kosovës në raport me autoritetet qendrore”.<sup>3</sup>

Për më tepër argumenti vazhdon se marrëveshja e 25 gushtit nuk është marrëveshje ndërkombëtare po legjislacion i zbatueshëm që derivon nga një marrëveshje ndërkombëtare (Marrëveshja e Parë e 19 prillit 2013), duke nënkuptuar që nuk ka nevojë të ratifikohet nga Kuvendi. Si e tillë, kjo është një marrëveshje që nuk ka nevojë për ratifikim nga Kuvendi, dhe si e tillë nuk mund të dërgohet formalisht në Gjykatën Kushtetuese. Kjo e bën Presidentet autoritetin e vetëm të autorizuar të dërgojë marrëveshjen për shqyrtim në Gjykatë.<sup>4</sup>

Arsyeja pas kërkesës për pezullim të të gjitha aktiviteteve dhe efekteve të prodhuara nga marrëveshja është bllokada e punës së Kuvendit nga ana e opozitës me akuza se marrëveshja nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe interesi publik që të evitohen eskalimet e tensioneve dhe të lejohet shteti që të funksionojë duke i dhënë kredibilitet institucional

<sup>1</sup> GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, [Vendim për masë të përkohshme Nr. K0130/15](#) (10 nëntor 2015), f.2.

<sup>2</sup> GJYKATA KUSHTETUESE: *Vendimi*. f. 2.

<sup>3</sup> Asociacioni/Komuniteti i komunave me shumicë serbe në Kosovë - parimet e përgjithshme/elementet kryesore, neni. 9.

<sup>4</sup> GJYKATA KUSHTETUESE: *Vendimi*. f. 5.

kërkesave që shkaktuan bllokadën.<sup>5</sup> Vërtetë, nëse Gjykata Kushtetuese vendos që marrëveshja për Asociacionin është në përputhje me principet kushtetuese, kjo do të mund ta bënte miratimin e marrëveshjes dhe ligjeve përcjellëse nga qeveria dhe Kuvendi më të lehtë, dhe me mbështetje të fuqishme ligjore.

*Pezullimi i marrëveshjes është në interes të publikut: është e nevojshme që të evitohet eskalimi i situatës dhe të hiqet dorë nga bllokimi i Kuvendit.*

Më 10 nëntor, Gjykata bëri publike vendimin e saj me anë të së cilit u pajtua me kërkesën e Presidentet për masë të përkohshme të cilën e morri menjëherë dhe e cila zgjat deri më 12 janar të vitit 2016. Gjykata gjithashtu deklaroi se masa e përkohshme nuk paragjykon pranueshmërinë ose meritat e kërkesës si të tillë, dhe i ka ofruar qeverisë,

deputetetëve të Kuvendit si dhe Avokatit të Popullit mundësinë për të ofruar komente për kërkesën.<sup>6</sup>

Ashtu siç pritej, palët kanë reaguar shumë ndryshe në Kosovë dhe Serbi. Kryeministri Mustafa është zotuar se do të mbështesë dhe implementojë çfarëdo vendimi të marrë nga Gjykata Kushtetuese dhe se qeveria do të vazhdojë të ofrojë kontribut konstruktiv në dialogun me Serbinë, duke shtuar se kjo është procedurë normale e paraparë në marrëveshje.<sup>7</sup> Partitë opozitare në Kosovë, në anën tjetër, e kanë cilësuar vendimin si “fitore të opozitës”, dhe janë zotuar se do të vazhdojnë me protesta dhe aktivitete tjera, duke shtuar se ato “nuk do të presin Gjykatën të marrë vendimine”, dhe se “Gjykata është kapur nga shteti”.<sup>8</sup>

*A është vendimi një procedurë normale, a nënkupton kjo fitore të opozitës apo është një taktikë e re për të shtyer themelimin e Asociacionit?*

Zyrtarë serbë, duke përfshirë këtu ministrin e punëve të jashtme të Serbisë Dačić dhe kreun e Zyres për Kosovën të qeverisë së Serbisë Đurić, e kanë akuzuar Kosovën se është duke përdorur manevra taktike për të shtyer themelimin e Asociacionit, dhe i kanë bërë thirrje BE-së që të ushtrojë presion mbi Kosovën për të themeluar Asociacionin.<sup>9</sup> Partneri junior në koalicionin qeverisës të Kosovës, Srpska lista (Liste serbe) gjithashtu i bëri thirrje Brukselit që të ushtroje presion ndaj Kosovës për themelimit të Asociacionit dhe tërhoqi vërejtjen se vendimi ngadalëson punën për përmirësimin e pozitës së komunitetit serb në Kosovë.<sup>10</sup>

Problemi kryesor me vendimin për të dërguar marrëveshjen për verifikimin në Gjykatën Kushtetuese është se marrëveshja definon principet dhe elementet kryesore të Asociacionit, por se nuk përcakton saktësisht se si Asociacioni do të funksionojë. Kjo në veçanti vlen për marrëdhëniet e Asociacionit me komunat pjesëmarrëse dhe me Republikën e Serbisë.<sup>11</sup> Natyra mono-etnike e Asociacionit është një çështje brengosëse që duhet të adresohet në versionin

<sup>5</sup> GJYKATA KUSHTETUESE: *Vendimi*, f.6.

<sup>6</sup> GJYKATA KUSHTETUESE: *Vendimi*, faqet 6–8.

<sup>7</sup> <http://koha.net/?id=27&l=83755>

<sup>8</sup> <http://www.gazetaexpress.com/lajme/opozita-e-quan-fitore-pezuillimin-e-asociacionit-thone-se-i-kane-1001-arsye-per-te-mos-i-besuar-gjykates-143784/>

<sup>9</sup> <http://www.rtklive.com/rtk2/?id=2&r=3716>

<sup>10</sup> <http://www.rtklive.com/rtk2/?id=2&r=3723>; <http://www.gazetaexpress.com/lajme/lista-serbe-kerkon-nga-be-ja-t-i-beje-presion-prishtines-per-asociacionin-143954/>; <http://www.rtklive.com/rtk2/?id=2&r=3717>.

<sup>11</sup> ECMI Kosova. ‘Marrëveshja e re mbi Asociacionin/ Bashkësinë e komunave me shumicë serbe: Një hap i rëndësishëm përpara, por jo fjala e fundit’ (7 shtator 2015).

final të legjislacionit.<sup>12</sup> Megjithatë, çfarëdo vlerësimi për atë se si do të funksionojë Asociacioni në kornizë të Kosovës është i hershëm dhe spekulativ në këtë fazë të zhvillimeve.

*Çfarëdo vlerësimi në këtë stazë është spekulativ: Marrëveshja definon vetëm principet dhe elementet kryesore*

Qeveria ka dhënë argumente se procedura është në përputhje me nenin 2 të Marrëveshjes. Kjo duket të jetë një lexim shumë liberal i Marrëveshjes, i cili thotë se "Qeveria e Kosovës do të miratojë një dekret drejtpërdrejt të zbatueshëm, i cili do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës".<sup>13</sup> Me fjalë të tjera, dekreti përfundimtarë që

rregullon çështjen e themelimit të Asociacionit do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese dhe jo nga Marrëveshja. Një procedurë e tillë në të vërtetë duket të jetë shumë më efektive, pasi do të lejojë partnerët të sqarojnë të gjitha çështjet e pazgjidhura në lidhje me funksionimin e Asociacionit dhe Gjykatës Kushtetuese për të marrë një vendim gjithëpërfshirës nëse krijimi i Asociacionit është në përputhje me kornizën kushtetuese të Kosovës.

Ky veprim është edhe një vonesë në zbatimin e marrëveshjes së pare të 19 prillit, 2013 për Asociacionin. ECMI Kosova në vazhdimësi e ka ngritur problemin e afateve kohore për së tepërmi optimiste të Marrëveshjes së 19 prillit, 2013, e cila parashikonte se Asociacioni do të themelohet brenda gjashtë muajsh,<sup>14</sup> dhe marrëveshjes së fundit të 25 gushtit, 2015 e cila përsëri parashikon themelimin e Asociacionit deri në fund të vitit. Themelimit të Asociacionit duhet t'i qaset me shumë kujdes duke përfshirë të gjithë aktorët relevantë, përfshirë Kuvendin e Kosovës. Shkelja e vazhdueshme e afateve tejet optimiste vetëm sa zvogëlon nivelin e ulët të besimit që pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë kanë në vullnetin e mirëfilltë të Qeverisë së Kosovës për të zbatuar marrëveshjet e arritura në dialogun e Brukselit dhe në këtë mënyrë të ndikojë negativisht në integrimin e komunitetit serb në Kosovë.

*Hapi i fundit është edhe një vonesë tjetër që diskrediton rëndë institucionet e Kosovës në mesin e pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë.*

Përveç kësaj, është krejt e panjohur në këtë moment se si, pezullimi i përkohshëm i Marrëveshjes për Asociacionin, apo në të vërtetë pezullimi i përgjithshëm në një vendim të mundshëm të mëvonshëm nga Gjykata Kushtetuese, mund të ndikojë në progresin që Kosova ka bërë në rrugën e saj drejt integritit evropian. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës, nënshkruar më 27 tetor, 2015, është një moment historik për marrëdhëniet BE-Kosovë. Megjithatë, marrëveshja është kushtëzuar me "angazhimin e vazhdueshëm të Kosovës drejt një përmirësimi të dukshëm dhe të qëndrueshëm në marrëdhëniet e saj me Serbinë".<sup>15</sup> Kjo nënkupton se Kosova është e obliguar që të kontribuojë në procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, gjë kjo që duhet të "sigurojë se të dy palët mund të vazhdojnë në rrugën e tyre përkatëse evropiane, duke shmangur situatat kur ndonjëra nga palët mund të bllokohen tjetrën në këto përpjekje, dhe gradualisht do të çonin në

<sup>12</sup> ECMI Kosova. [‘Asociacioni / Bashkësia e komunave me shumicë serbe: Një klub ekskluziv i bazuar në përkatësinë etnike?’](#) (31 mars, 2015).

<sup>13</sup> <http://koha.net/?id=27&l=83755>

<sup>14</sup> ECMI Kosova. [‘Asociacioni / Bashkësia e komunave me shumicë serbe: Shumë spekulime, pak marrëveshje faktike dhe moszbatim’](#) (23 shkurt, 2015).

<sup>15</sup> [‘Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Komunitetit evropian të energjisë bërthamore, nga njëra anë, dhe Kosovës\\*, nga ana tjetër’](#) (27 tetor, 2015), Neni 5.

normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, në formën e një marrëveshje ligjërish të detyrueshme, me perspektivën që të dyja palët të jenë në gjendje të ushtrojnë

*Është e paqartë nëse pezullimi i Marrëveshjes do të ketë një ndikim negativ në progresin e bërë në Kosovë drejt integritit në BE.*

plotësisht të drejtat e tyre dhe të përmbushin përgjegjësitë”.<sup>16</sup>

Duke marrë parasysh këtë që u tha më sipër, Kosova duhet të zbatojë në mirëbesim të gjitha marrëveshjet e arritura në dialogun me Serbinë.<sup>17</sup> Në rast të mosrespektimit të këtyre angazhime nga Kosova, BE-ja mund të marrë masat që i gjykon të përshtatshme, duke përfshirë edhe pezullimin e MSA-së.<sup>18</sup> Për sa i përket pjesës së saj, BE-ja nuk ka marrë një qëndrim mbi vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por ka deklaruar se pret

që të dyja palët të përmbushin detyrimet e tyre në kuadër të procesit të dialogut të Brukselit.<sup>19</sup>

Pezullimi i përkohshëm, më së paku, duhet t’i hap rrugën një atmosferë më të qetë në mes të pozitës - përfshirë përfaqësuesit e komunitetit serb të Kosovës - dhe opozitës dhe të lejojë një debat të përtërirë mbi kualitetin e Marrëveshjes dhe të Asociacionit, dhe se si të vazhdohet përpara në mënyrën më të mirë. Edhe pse opozita tashmë ka deklaruar se ata e shohin pezullimin vetëm si një masë të përkohshme dhe se nuk do të tërhiqet nga kërkesa e tyre për tërheqjen e nënshkrimit nga marrëveshja, qetësia e përkohshme sa i përket aktiviteteve mund ta bëjë më të lehtë për të dyja palët për tu takuar mes vete dhe të shohim nëse mund të gjejnë një mirëkuptim dhe gjuhë të përbashkët sa i përket dialogut të Brukselit në përgjithësi dhe Asociacionit në veçanti.

*Nëpërmjet **Kosovo Communities Issues Monitor**, (Monitoruesit të Çështjeve të Komuniteteve të Kosovës) ECMI Kosova monitoron, analizon dhe ofron rekomandime mbi zhvillimet dhe shqetësimet që ndërliken me pozicionin e komuniteteve pakicë në Kosovë, brenda kornizës së legjislacionit ndërkombëtar dhe vendor mbi të drejtat e pakicave. Analizat e paraqitura në Monitorues janë të mbështetura në monitorimin e rregullt dhe të ngushtë të medieve dhe intervistave me palë përkatëse të interesit. Në ndërkohë që ECMI Kosova përpiqet në çdo kohë që të sigurojë informacion të saktë dhe të nuancuar për të prezantuar pikëpamjet dhe perceptimet e të gjitha palëve, objektivi apo synimi i Monitoruesit nuk është që të sigurojë mbulim gazetaresk apo paraqitje faktike, por të ofrojë një element shtesë analitikë të debatit, duke reflektuar përvojën afatgjate të ECMI Kosovës mbi çështjet që kanë të bëjnë me komunitete pakicë në Republikën e Kosovës dhe kuadrin ekzistues ligjor të Kosovës dhe atë ndërkombëtar.*

<sup>16</sup> ‘Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit’, Neni 13 (2).

<sup>17</sup> ‘Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit’, Neni 13 (3.a).

<sup>18</sup> ‘Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit’, Neni 5.

<sup>19</sup> <http://www.gazetaexpress.com/lajme/be-nuk-komenton-vendimin-e-gjykatës-kushtetuese-pret-themelimin-e-asociacionit-143965/>

## Raporte dhe analiza politike të tjera të realizuara nga ECMI Kosova:

[Kosova dhe UNESCO: Për një përqëndrim të ri në debat](#)

**8 nëntor, 2015**

[Komunitetet pakicë në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës: A ka abuzime me sistemin e kuotave?](#)

**15 tetor, 2015**

[Për një diskutim gjithëpërfshirës mbi asociacionin e komunave me shumicë serbe](#)

**8 tetor, 2015**

[Marrëveshja e re mbi asociacionin/bashkësinë e komunave me shumicë serbe: hap i rëndësishëm përpara, por jo fjala e fundit](#)

**7 shtator, 2015**

[Mosmarrëveshjet lidhur me përdorimin e gjuhëve në Kosovë si dhe implementimi i dobët i kornizës ligjore](#)

**2 gusht, 2015**

[Hyn në fuqi pakoja e ligjeve për të drejtat e njeriut](#)

**26 korrik, 2015**

[Mbi trendin shqetësues të incidenteve të drejtuara ndaj komitetit serb në regionin e Pejës dhe Klinës](#)

**19 korrik, 2015**

[Vivovdani: Mungesa e lajmeve është lajm i mirë](#)

**2 korrik, 2015**

[Rreth incidenteve të fundit në Klinë dhe procesin e ngadalshëm të kthimit](#)

**21 maj, 2015**

[Dita memoriale e goranëve më 6 maj: Një mundësi e humbur për institucionet e Kosovës](#)

**14 maj, 2015**

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Çfarë është e \(pa\)mundur në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës?](#)

**16 prill, 2015**

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Një klub ekskluziv I bazuar në përkatësinë etnike?](#)

**31 mars, 2015**

### Rreth ECMI Kosovës

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumetnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit kapacitetet e aktorëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëpunuar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.